

SHËPËRTHIMI RI REVOLUCIONIT

Ebu Mundhir Shenkiti

MINBERI TEUHIDIT



Përktheu: Rexhep MEMISHI



Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Frone të cilat rrëzohen..... | 3 |
| Shfrytëzimi i shansës..... | 4 |
| O ju të rrinj:..... | 5 |
| Revolucion mbi zullumin dhe nënçmimin..... | 6 |
| Revolucioni i popullit dhe heshtja e dijetarëve | 7 |
| Historia nuk ka hatër në askënd! | 8 |
| Kërcimet kardavite | 9 |
| Kryengritja jo Islame | 11 |
| Gaca (e protestave) ishte vetëvrasja jo Islame..... | 13 |

SHPËRTHIMI I REVOLUCIONIT

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve, mbështetësit të Pejgamberit të Tij fisnik, paqja dhe mëshira e tij qoftë mbi të Dërguarin e Tij, familjen dhe shokët e Tij.

Dhe më pas:

Allahu teala thotë: **“Ne, këto ditë i ndërrojmë (u japim në përdorim) mes njerëzve për t’u ditur tek All-llahu ata që besuan dhe për t’i zgjedhur disa prej jush për dëshmorë (ose dëshmues). All-llahu nuk i do zullumqarët”**. (Ali Imran, 140)

Gjithashtu, Ai thotë: **“Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do, e lartëson atë që do dhe e përul atë që do”**. (Ali Imran, 26)

Transmetohet nga Ebu Musa r.a. se i Dërguari i Allahut sal’allahu alejhi ue selem ka thënë: Allahu e lenë të padrejtin, kur ta dënon nuk e shpëton, pasaj lexoi: **“Ky është All-llahu, Zoti juaj, nuk ka të adhurar përveç Tij, Krijues i çdo sendi, pra adhurojeni Atë; Ai është mbikëqyrës ndaj çdo sendi”**. (En’am, 102)

Transmetohet nga Hudhejfe r.a. se Pejgamberi sal’allahu alejhi ue selem ka thënë: Do të jetë pejgamberia tek ju aq sa të dëshiron Allahu të jetë, pastaj Ai do ta ngritë atë kur të dëshiron të ngritet, pastaj do të jetë hilafeti sipas metodës së pejgamberisë, kjo do të jetë aq sa të dëshiron Allahu, pastaj do ta ngritë Allahu kur të dëshiron ta ngritë. Pastaj do të ketë sundim me trashëgimi, kjo do të ekziston aq sa të dëshiron Allahu, pastaj do ta ngritë këtë kur të dëshiron Ai, pastaj do të ketë sundim diktatorial, kjo do të jetë aq sa të dëshiron Allahu të ekziston. Pastaj do ta ngritë kur të dëshiron ta ngritë, pastaj do të jetë hilafeti sipas metodës së pejgamberisë, pastaj heshti”. (Transmeton Ahmedi)

Frone të cilat rrëzohen

Popujt musliman, pas daljes së kolonialistëve nga vendi i tyre, jetuan nën qeveri dhe mbretëri pa dëshirën e tyre, të penguar nga jeta njerëzore e bujshme, nën qeverisje diktatoriale të cilët nuk shenjtërojnë sheriatin, dhe as që mëshirojnë njerëzit...

Popujt musliman sot demonstrojnë para mbretërive dhe qeverive diktatoriale për t’i larguar nga zullumi dhe tirania, për t’i dhënë fund lojalitetit të tyre ndaj zotërinjve të tyre nga perëndimi.

Këto popuj (muslimanë) janë torturuar, nënçmuar dhe dënuar shumë, andaj si rezultat i kësaj, ishte ky shpërthim i madh...

Këto janë fronet të cilat rrëzohen, rënia e tyre do t'ia shkurton ummetit një gjatësi të shumtë të rrugës së gjatë, të cilën rrugë të gjatë e synonin shumë prej bijve të ummetit... Ata e shihnin se është obligim dhe detyrë të durohet në këtë rrugë të gjatë...e cila do t'ua hapë shumë dyer të cilat ishin të mbyllura. Në të ardhmen, shumë prej kërkesave të cilat ishin të pamundura, do të jipen.

Pra, është afruar koha kur do të shpëtojmë nga qeveritë diktatoriale.

Është koha për t'u liruar nga qeveritë mbretërore, të cilat i refuzon realiteti jetësorë dhe ai i sheriatit. Nuk ka baza në sheriatë apo logjikë për t'u orvatur që këto dinasti të mbesin në pushtet.

Këta mbretër vazhduan të luajnë me pasurinë e ummetit, saqë kjo është bërë barrë e rëndë për vendet Islame, prandaj popujt musliman duhet t'i largojnë nga qeverisja.

Tani është koha që ummeti Islam t'i pyes:

Kush ua dha të drejtën e sundimit?

Kush ua dha të drejtën që vendin ta bëni arrë tuajën ekskluzive, që ia jepni cilit dëshironi dhe ua ndaloni cilit dëshironi prej njerëzve?

Kush ua dha të drejtën që t'i bëni rrobërit e Allahut si kope të deleve, që të mbysni kë të dëshironi prej tyre dhe t'i leni të gjallë ata që dëshironi?

Koha është që popujt t'u thonë me një zë së bashku: O ju mbretër, nuk keni të drejtë në tokën e Allahut, nuk keni pushtet mbi rrobërit e Allahut...

Shfrytëzimi i shansës

Që kjo dhunti popullore t'i japë frytet e saja, duhet të marin pjesë në të të gjithë, që të bashkohen në këtë qëllim.

Në këtë moment vendimtarë është obligim për neve të marim pjesë në këtë ngjarje duke e ndërtuar atë me të gjitha mjetet dhe mundësitë të cilat i posedojmë.

Çdonjëri i cili ndalet dhe nuk kontribon për rënien e këtyre froneve, zullumqarëve, është tradhtarë ndaj fesë dhe ummetit të tij.

Andaj, ti rrinjtë e xhihadit dhe përkrahësit e tij, të cilët nuk gjenin mundësi për të arritur në frone, le të jenë në radhët e para të turmave, le të tregojnë shembull trimërie, sakrifice dhe sfidë ndaj zullumqarëve.

Sot është dita juaj o ju përkrahës të xhihadit...

Ai i cili nuk ka mundësi të jetë në fillim të turmave protestuese ku mund të dalin edhe fëmijët, atëherë mos të flet për luftë në fushëbeteja...

Nëse gjendja ishte e këtillë më parë për t'u formuar këto udhëheqësi dhe mbretëri në vendet Islame, gjendja e sodit është për të shpëtuar dhe liruar prej tyre...

Prandaj, popujt musliman duhet të shfrytëzojnë këtë shansë për të lëvizur për t'i zhdukur ata...o miku im, s'ka mjerim më të madh se njeriu i cili e ka shansën, mirëpo dështon!

Popujt, sot kanë plagë të brendshme, andaj çdo demonstratë do të shpalojë këtë plagë në sipërfaqe...

Çdo kundërshtim ndaj protestave do të shpie deri në shtim të plagës së brendshme...!

Kështu do të mbesin këto qeveri në huti duke e parë tufanin i cili vjen!

Çdo protestë në Jemen, Jordan apo në vendin e Dy Haremeve, do të jetë ndezje e një fije në afërsi të gazit!

Çdo orvatje për të penguar këto protesta, do të jetë si hudhje e vajit në zjarr!

Iniciativa sot është në duart e popullit, udhëheqësit vetëm presin se çfarë fshihet pas kaderit...

Ata para turmave revolucionare janë si një fëmijë i vogël i cili mundohet ta ndalë stuhinë...!

O ju të rrinj:

Shfrytëzoni këtë shansë, dilni në protesta kundër qeverive të mbetura të tagutëve...

Nëse nuk protestoni sot, nuk do të mundni pas kësaj, asnjëherë...

Nëse protestoni në këtë periudhë, mund të kërkon çdo gjë...

Të rrinjtë e kanë për obligim ndezjen e fitilit të revolucionit, e nëse këtë nuk e bëjnë, kjo është prej dobësisë...

Nëse ajo dështon, atëherë duhet të përsëritet ajo...

Nuk ka vend frika pas kësaj...

Humbet frika, ajo nuk ekziston pastaj...

Udhëheqësit tani kanë formuar grupe të cilat i përkrahin në vendet që bëhen protesta, që të asgjësojnë çdo protestë para se t'i rrezikon ata...

Kjo mund të përballohet me përgatitje të mirë dhe propagandë të mirë ndaj protestave...

Nëse qeveria shpërndanë protestuesit dhe demonstratat, atëherë duhet të përsëritet e njëjta...

Me përsëritjen e protestave do të shtohen përkrahësit dhe do të përgjigjet qeveria ndaj disa kërkesave, atëherë do të fillon ta lehtëson pranimin e kërkesave.

Kjo është një luftë, arma e vetme e së cilës është vullneti, ai i cili ka vendosshmëri më të madhe, është fitues...

Duhet patjetër të shpalosen gabimet e këtyre qeverive, të tregohet se ata janë bashkëpunorë të perëndimit, kjo duhet të bëhet përmes dokumentarëve, fakteve, numrave dhe dëshmimeve, e pastaj të shpërndahen tek njerëzit...

Është me rëndësi të përmendet se qeveritë dallojnë mes vete sa i përket kundërvënies ndaj revolucioneve...

Qeveria e atij i cili është i vetëm, nuk mund të duron shumë revolucione, ndërsa qeverisja e cila përkrahet nga një grup apo ushtri, e cila qeverisë pas perdes, është më e fuqishme për t'i përballuar revolucionet.

I pari mbrohet me popullin e tij, ndërsa i dyti me dekorin e ligjit të cilin e ka vendosur vetë.

Mirëpo, sado që të duken këto qeveri të fuqishme, ato janë të dobëta.

Muri i nacionalizmit dhe dekori i legjitimitetit do të zvizhet kur të përplasat me protestuesit.

Revolucion mbi zullumin dhe nënçmimin

Revolucioni në Tunis ishte fillim dhe nxitës për revolucionet kundër këtyre qeverive, ikë i burgosuri nga gardiani i burgut...Kur të del në liri, atëherë të burgosurit e tjerë s'mund të bëjnë diç pos ta pasojnë...

Ndërsa revolucioni në Egjipt kishte atmosferë revolucionare, njerëzit jetuan ditë të revolucionit, ata panë se si lindi krenaria dhe si fitohet nderi...

Ata shijuan fjalën e poetit arab: Atëherë kur sundimi të lëshon njerëzit, ne refuzojmë të pranojmë nënçmimin.

Për këtë dëshmon e vërteta në fushë se e kota është e dobët sado që posedon prej mjeteve dhe fuqisë. Dhe se e vërteta është e fuqishme, sado që duket nga jashtë se është e dobët.

Kjo bëri që shpirtërat t'u mbushen me trimëri, krenari, urrejtje ndaj zullumit dhe nënçmim ndaj të padrejtëve.

Ishte prej mirësisë ndaj neve ajo që taguti Mubarak nuk dha dorëheqje menjëherë, kur ai nuk iku nga vendi. Ai dha shansë për lindje të një revolucioni me frymëmarje më të gjatë, kjo bëri që të përhapet në të gjitha vendet, madje kjo bëri që të marin pjesë të gjithë, edhe disa pasues të parisë së parë.

Revolucioni në Egjipt kishte sukses për të çliruar shpirtërat nga frika e tagutëve dhe nënshtrimi ndaj tyre...

Revolucioni i popullit dhe heshtja e dijetarëve

Për fat të keq, roli i dijetarëve ngeci shumë mbrapa në krahasim me rolin e gazetarëve, politikanëve dhe mendimtarëve...

Dijetarët u ndalën në xhami dhe kuvende të tyre dhe ua lanë fushën thatë të lartëpërmendurve duke ndikuar në mendimin e publikut, duke e udhëhequr ata...

Ndërsa, siç është e natyrshme, njerëzit dëgjojnë vetëm ata të cilët ndajnë brengën dhe dhimbjet...

Dijetarët gjatë kohëve të ndryshme ishin liderë të revolucioneve kundër çdo tirani nga qeveritarët, ata për këtë dhanë shpirtërat e tyre.

Seid ibn Xhubejri ishte prej liderëve gjatë kryengritjes kundër Haxhxhaxh ibn Jusuf, ai qëndroi në këtë derisa Haxhxhaxhi e vrau.

Ibn Kethiri duke treguar për Seidin thotë: “Seid ibn Xhubejrin, thuhet se e kanë quajtur edhe Ebu Abdilah. Ai është nga Kufja, pastaj nga Meka, prej nxënësve të mëdhenjë të Ibn Abbasit r.a. Ishte imam i muslimanëve në tefsir, fikh dhe shkenca tjera. Bënte shumë vepra të mira, Allahu e mëshiroftë.

Takoi disa prej sahabëve. Transmetoi nga disa prej tyre, ndërsa prej tij shumë prej tabiinëve. Thuhet se ai e ka lexuar Kur’anin në tërësi mes namazit të akshamit dhe jacisë. Lexonte një hatme të Kur’anit gjatë një ulje në Qabe, madje e lexonte në brendi të Qabes për një rekat. Transmetohet nga ai se e ka lexuar Kur’anin dy herë e gjysëm në namaz gjatë një nate.

Sufjan Theurij transmeton nga Amër ibn Mejmun, e ai nga babai i tij se pasi që vdiq Seid ibn Xhubejri, të gjithë banorët e tokës kishin nevojë për diturinë e tij”. (Bidaje ve Nihaje, 116/9)

Ai ishte prej dijetarëve të cilët dolën kundër udhëheqësve të padrejtë, të cilët i nxitën njerëzit që të luftojnë kundër tij. Prej tyre ishte edhe Ahmed ibn Nasër El-Huzajj, Allahu e mëshiroftë. Ai i mblodhi njerëzit që ta kundërshtojnë Vathikun, kjo ishte edhe shkaku i vrasjes së tij.

Ibn Kethiri thotë: “Ahmed ibn Nasri kishte autoritet dhe pozitë të lartë. Babai i tij Nasr ibn Malik ishte mikpritës i ithtarëve të hadithit. Atij ia dhanë besën njerëzit në vitin 201 për të urdhëruar

dhe ndaluar nga e keqja, kur kurvëria ishte shtuar gjatë mungesës së Me'munit. Kështu, u bë e njohur udhëheqësia e Nasrit në Bagdad. Ahmed ibn Nasri ishte prej dijetarëve të devotshëm, i cili bënte shumë vepra të mira.

Ishte prej imamëve të sunnetit të cilët urdhëronin në të mirë dhe ndalonin nga e keqja. Ishte thirrës në atë se Kur'ani është fjalë e Allahut e zbritur dhe nuk është e krijuar.

Ndërsa Vathiku ishte thirrës në çështjen e krijimit të Kur'anit, i cili natë dhe ditë bënte thirrje për këtë, haptazi dhe fshehtas, duke u bazuar në mendimin e babait dhe xhaxhait të tij Me'munit, gjë për të cilën nuk posedonte ndonjë argument. Kështu, Ahmed ibn Nasr u ngrit për të urdhëruar në të mirë dhe ndaluar nga e keqja dhe se Kur'ani është fjalë e Allahut dhe nuk është e krijuar, si dhe shumë çështje të shumëta në të cilat i thërriste njerëzit.

Rreth tij u mbledhën një grup nga banorët e Bagdadit, edhe atë me mijëra. Për Ahmed ibn Nasrin bënë thirrje dy njerëz, Ebu Harun Seraxh nga ana e lindjes dhe tjetri i cili quhej Talib që thërriste nga ana perëndimore. Kështu, u mbledhën mijëra njerëz. Në muajin Shaban, iu dha besa Ahmed ibn Nasrit fshehtas për të urdhëruar në të mirë dhe ndaluar nga e keqja, për të dalur kundër sulltanit përshkak bidatit të tij dhe thirrjes së tij se Kur'ani është i krijuar, për arsye të mëkateve dhe amoralitetit të tij dhe emirëve të tij, etj". (Bidaje ve Nihaje 334/10)

Dijetarët e ummetit sot janë para një provimi të rëndë, rezultatet e tyre do të varrosen në faqet e historisë, ata do t'i përmendin gjeneratat të cilat vijnë. Nuk do të harohen këto çaste dhe qëndrime, pra ose do të jenë ose nuk do të jenë...

Historia nuk ka hatër në askënd!

Nëse nuk kanë ndonjë influencë gjatë momenteve të vështira në ummet, atëherë cili është roli i tyre?

Obligim i sheriatit është që ata t'u prijnë radhëve, që ata të jenë liderë, e jo të udhëhequr, ata janë veprues e jo shikues, janë ndikues e jo të ndikuar, nxitës e jo tradhëtues.

Le të zbresin dijetarët në fushë, le të marin pjesë me masën për të larguar tiranët, për të zhdukur zullumin.

Le t'i nxisin njerëzit për dridhjen e froneve të tyre, që të thyhet tirania...

Tiranët vazhdojnë të sundojnë tokat tona, përderisa janë në pushtet, ata vazhdojnë me tirani dhe zullum...

Është tradhëti nëse i lëmë këta të rrinjë musliman të luftojnë me qeveritë diktatoriale, pastaj pas kësaj t'i mbledhim frytet ne, ndërsa ata i kanë larguar therrat!

Për fat të keq, organizatat dhe institucionet fetare, të cilat janë formuar nën urdhëra të këtyre qeveritarëve, u shërbejnë kryetarëve më shumë se sa fesë. Ata shpjegojnë më shumë mendimet e kryetarëve të cilët qeverisin, se sa mendimin i cili e pëfaqëson fenë.

Madje, roli i këtyre organizatave është i njëjtë me rolin e kishës e cila përkrahi mbretërinë gjatë revolucionit francez dhe atë bolshevik. Kjo ishte shkaku kryesorë që kryengritësit brohorisnin fjalën e Mirabos: “Vareni mbretin e fundit me zorët e priftit të fundit”.

Rreth kësaj, Tomas Xheferson thotë: “Priftërinjtë në çdo vend dhe çdo kohë janë armiq të lirisë, ata çdoherë janë aleat të kryetarit tiran-diktatorë. Ata e ndihmojnë në mëkate dhe e mbrojnë deri në fund”.

Prandaj, nuk u takon dijetarëve musliman të ecin pas hapave të kishës duke e përkrahur zullumin.

Përndryshe, le ta dije çdonjëri i cili mundohet të pengon këtë kryengritje, apo ndaljen e hovit, se ai është prej të padrejtëve të cilët do të bartin mëkatin e asaj çfarë ndodhë sot në ummet prej zullumit të zullumqarëve. Madje, ky person është në hendekun e armiqve të ummetit.

Kërcimet kardavite

Poashtu, nuk u takon dijetarëve që të nisen nga rregulli “nënshtrohemi nëse njerëzit nënshtrohen, protestojmë kur ata protestojnë”, siç bën Kardavi i cili nuk kundërshton asnjë tiran, vetëm nëse kundërshtojnë edhe rojtaret e tij! Kështu, ai është bërë simbol i zërave të Al-XHEZIRËS!

Nuk mund të na mashtron hilja e Kardavit dhe përkrahja e turmës së kryengritjeve në Tunis dhe Egjipt, ai është prodhim i tagutit të Katarit, ai është hoxhë i tagutëve, prej garuesve për t’u shërbyer atyre.

Al-Xhezira mund t’i mashtron naivët nga publiku me kërcimet dhe fjalët e Kardavit...

Mirëpo, ajo nuk mund të mashtron historinë e cila regjistroi qëndrimet e Kardavit në përkrahjen e tagutëve.

Kur disa prej të rrinjve nga umeti u ngritën për t’u ballafaquar me tiraninë e qeverive, u ndal Kardavi në radhët e tiranëve qeveritarë duke u bërë shantazist, i quajti këta të rrinjë si injorant, ekstremistë dhe se janë në rrugën e havarixhëve.

Nxitja e Kardavit kundër qeverisë së Egjiptit duhej të bëhet kur qeveria e Egjiptit ndihmoi dhe mori pjesë në luftë kundër Irakut...duhej të bëhej kur Egjipti dhe qeveria e tij bashkëpunuan me çifutët në luftë kundër Gazës...

Ai qëndroi në të kundërtën e kësaj, duke kundërshtuar fetvanë të cilën e dhanë një qind dijetarë mbi tekfirin e kryetarit të Egjiptit, përshkak miqësisimit me çifutët në luftë kundër Gazës.

Qëndrimet e tij janë shumë të ngjashme me qëndrimet e perëndimit të cilët përkrahin kryetarët kur janë të fuqishëm dhe distancohen prej tyre kur ata dobësohen!

Ne e dimë se nuk ka kush i mëshiron tagutët pas humbjes, andaj nuk është e çuditshme që Kardavi kërceu nga ania e tyre para se të fundosen...

Mirëpo, është e çuditshme që Al-Xhezira, e cila mundohet që Kardavin ta paraqet si armik të kryetarëve, sikur të ketë haruar gjithë atë përkrahje për ata!!

Metoda e imitimit nuk përshtatet me rolin e udhëheqësisë të cilën duhet ta realizojnë dijetarët...

Ka dallim mes atij i cili e thotë fjalën e vërtetë tek sulltani i padrejtë, i cili përballat para vetes vrasje, burgosje apo vështirësi, dhe ai i cili e thotë fjalën e vërtetë kur i padrejti humb fuqinë. Kështu, ai largohet nga tirani të cilin e kishte përkrahur duke kërcyer nga ania para se të fundoset, që të fiton popullaritet me këtë.

Këtë e bëri Kardavi, i cili kishte mbrojtur kryetarët duke i tradhëtuar publikun nën moton “Pajtimi mes popullit dhe kryetarëve”.

Kardavi nuk kishte mbrojtur vetëm kryetarët, por edhe zotërinjtë e tyre të krishterë gjatë luftërave të kryqëzatave kundër Islamit dhe muslimanëve. Ai kritikoi luftën e 11 shtatorit, e konsideroi prej zullumit dhe armiqësisë. Ai u dha fetva muslimanëve të marin pjesë në ushtrinë Amerikane kundër Afganistanit.

Uzame Baz ishte shumë më i qartë dhe i drejtë kur foli për Al-Xhezirën, kur u kërkua prej tij tu flet egjiptianëve, ai tha se nuk meriton tu drejtohet me asnjë fjalë sepse ai dhe të tjerët në moshën e tij duhet ta konsiderojnë veten përgjegjës për gjendjen në të cilën ka arritur vendi.

Si mos të jetë Kardavi përgjegjës për gjendjen në të cilën arriti vendi kur ai gjatë gjithë këtyre viteve fliste për pajtimin mes popullit dhe kryetarëve.

Erdhi koha për largimin e tagutëve, historia do ta llogarisë çdonjërin i cili është ndalur në radhët e tyre prej dijetarëve, prej të parëve është Kardavi.

Nëse ky njeri është i sinqertë në nxitjen që e bën kundër qeverive, atëherë le të kërkon falje nga të rrinjtë e ummetit për gjithë atë përkrahje (që ua jipte tagutëve) gjatë viteve dhe le të na lajmëron për punëtorin e amerikanëve i cili quhet Hamed ibn Halife.

Dallimi mes Kardavit dhe të rrinjve të cilët u ngritën në kryengritje është ajo se këta të rrinj nuk kanë interesa dhe përfitime personale, apo përfitime partiake tek këto qeveri...

Ndërsa Kardavi, ka interesa në këto qeveri, ai përfiton prej tyre në aspektin personal dhe atë partiak (xhemati i ikhanëve).

Nuk duhet të harojmë këtë realitet se liderët e vjetër kanë dallim në përkatësinë mendore, këtu bëjnë pjesë edhe Ikhvanul muslimin, ata kanë disa interesa dhe përfitime në këtë realitet dhe të bëjnë ndryshime të ngadalshme që mos të thehet çelqi i interesave partiake!

Kjo bën që të mos jenë të përgatitur për të bërë ndryshime të plota dhe rrënjësore në qeveri!

Derisa populli kërkonte largimin e kryetarit, autori i ikhvanëve, Fehmi Huejdi në kanalën e Al-Xhezirës, në ditën e gjashtë të protestave tha: Kërkesa për largimin e kryetarit nuk është e mundshme!

Pas kësaj, foli Muhamed Selim Aua i cili e lavdëroi Omer Sulejmanin dhe Ahmed Shefikin, dhe i cilësoi si të ndershëm!

Prandaj, nuk është e çuditshme ajo se të rrinjtë të cilët filluan kryengritjen, nuk ishin nga ikhvanët ngase ikhvanët kishin interesa të përbashkëta me qeverinë e deri tashme.

Kryengritja jo Islame

Gabon ai i cili mendon se lufta të krishtere të cilën e zhvillon perëndimi kundër vendeve Islame është luftë fetare e cila zhvillohet vetëm për synime fetare.

Faktori fetarë në realitet ekziston...mirëpo përdoret si mjet, e jo si qëllim.

Qëllimi i tyre kryesorë është mbikqyrja e resurseve në vendet Islame, kontrollimi i tyre përmes punëtorëve të tyre.

Këtë e refuzojnë të gjithë popujt musliman, edhe ata të cilët janë islamik, edhe ata joislamik.

Kështu, fjala popull bashkon dhe dallimet treten nëse ka të bëjë me kryengritje e cila kërkon lirinë dhe udhëheqësinë, e cila kërkon largimin e kolonializimit të mbuluar siç ngjanë kjo në Tunis dhe Egjipt, ku mori pjesë i gjithë populli për të realizuar këto dy kryengritje.

Perëndimi mundohet çdoherë të shfaqet se frikësohet nga qeverisja e islamistëve sepse ata janë armiq të demokracisë dhe se ata dëshirojnë realizimin e ekzekutimeve të cilat janë në kundërshtim me të drejtat njerëzore...

Këto fjalë janë mashtruese, sepse në realitet ata frikësohen nga çdonjëri i cili i largon punëtorët e tyre, gjë kjo e cila nxjerrë vendet nga pushteti i tyre edhe nëse kjo realizohet përmes demokracisë e cila duket nga jashtë, e cila është në duart e sekularëve dhe liberalëve!

Frika e perëndimit nga islamikët është më e madhe sepse janë më të rrezikshëm ndaj tyre. Ngase ata të cilët janë më të fortë në të janë shumë seriozë në këputjen e lidhjeve dhe përfundim të sundimit të tyre. Kjo nuk është vetëm në nivel të ekonomisë dhe politikës, por edhe në nivel të mendimeve dhe të kulturës!

Madje, ata janë të gatshëm që të mungon demokracia, janë të gatshëm të pranojnë ekzekutimet nëse u jipet vendi dhe u nënshtrohen njerëzit!

Shembull për këtë është qëndrimi i Amerikës ndaj familjes së Saudit, edhe pse nuk ekziston demokracia, edhe pse sipërfaqësisht realizohen ekzekutimet e shariatit, Amerika nuk dënon qeverisjen e familjes së Saudit, gjë e cila ishte e kundërt me talibanët.

Prej kësaj mund të kuptojmë se pse qeveria alarmoi që mos të arrijnë ikhvanët në qeveri nëse kryengritja ka sukses, duke dëshiruar të përfitojnë se revolucioni është nga ikhvanët.

Kështu, ikhvanët e besuan këtë gënjeshtër për veten, andaj menduan se revolucioni është prodhim i duarve të tyre. Kështu shkuan për të biseduar me qeverinë. Prandaj, kur kuptuan se qëndrimet e tyre nuk kanë ndikim tek populli që protestonte, ata u kthyen nga këto negociata duke thënë: Negociatat tona me qeverinë ishin për t'ua matur impulsin!

Kjo është e vërtetë, mirëpo kjo është matje e impulseve të protestuesve e jo të qeverisë!

Amerika u mundua t'i mvëshë revolucionit natyrë partiake të ikhvanëve që të largohen prej kësaj njerëzit tjerë.

Në realitet, Amerika nuk frikësohet nga metoda e ikhvanëve, të cilët turpërohen nga therrja e një pule!

Është e vërtetë ajo se perëndimi frikësohet nga qeverisja e ikhvanëve, mirëpo, kjo nuk është frikë nga Islami i tyre, por frikësohen nga projekti i çlirimit të cilin dëshirojnë ta realizojnë. Pra, nga ky këndvështrim ata frikësohen edhe nga nacionalistët dhe nga çdonjëri i cili nuk u nënshtrohet perëndimit.

Ky revolucion i parashtrori një pyetje të hutuar perëndimit, e cila thotë: Çfarë është dobia ynë e luftës tonë kundër Islamit dhe islamistëve kur edhe sekularët dhe mesatarët synojnë pavarësinë reale të vendit?

Pyetja në formë tjetër thotë: Nëse ne e largojmë ngjyrën Islame nga bota Islame, a mund të largojmë nga shpirti i bijëve të tyre dashurinë e lirisë dhe krenarisë e cila i largon nga shkelja dhe nënçmimi?

Perëndimi u frikësua nga revolucioni Islamik, atyre u erdhi revolucioni jo Islamik...

Gaca (e protestave) ishte vetëvrasja jo Islame...

Lëndë djegëse ishin ata të rrinjë të cilët i krijoi media, edukata dhe sigurimi i Ben Alijut, e cila kishte metodë jo Islame!

Kryetarët e perëndimit mbetën të habitur e jo të gëzuar, duke thënë: Kjo është revolucion jo Islamik!

Ne themi:

Ka të tillë të cilët kërkojnë lirinë, drejtësin dhe demokracinë...

Mirëpo, ne kërkojmë lirinë, drejtësinë dhe Sheriatin...

Duhet ta dijnë të gjithë se në vendet Islame nuk ka qetësi dhe stabilitet derisa të zbatohet Sheriati në tokat e tyre.

Prandaj, prej zullumit dhe diktaturës është që muslimanët të pengohen nga zbatimi i Sheriatit në tokat e tyre.

Le ta kuptojnë këtë ndihmësit e demokracisë prej kryengritësve, para se të na detyrojnë të bëjmë revolucion kësaj radhe – Islamik të çiltër.

Allahu është më I Dituri, falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve.

Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi Muhammedin sal'allahu alejhi ue selem, familjen dhe shokët e tij.

Ebu Mundhir Shenkitij

Përktheu: **Rexhep MEMISHI**

Realizoi dhe përgatiti: **Teuhid.NET**